



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.914/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci, kryesues paneli,, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, Faton Berisha nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), dega në Komunën e Klinës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.914/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, Faton Berisha, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatët për Kuvend Komunal në Kline nga Subjekti Politik LDK, në këto Vendvotime: 0803C/01R, 0807C/03R, 0810C/02D

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Klinës, Faton Berisha nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Klinës, me të cilën pretendon se ka dyshime të bazuara që gjatë procesit të numrimit të votave kanë ndodhur keqpërdorime në disa vendvotime, duke devijuar vullnetin e sovranit. Më tutje parashtresë i apelit pretendon se në natën e 17 Tetorit gjatë procesit të numrimit të votave, përkatësisht gjatë bartjes së votave nga Fletët Llogaritëse në Formularët e Rezultateve për Kandidat (FRK) ka dyshime të bazuara se i'u janë tjetërsuar votat. Parashtresë i apelit thekson se duke pasur parasysh se kjo bie ndesh me nenin 101 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 20 parag.1 të Rregullës Zgjedhore 09/13, atëher konsideron se kutitë e votave për Kuvend Komunal që do të listonte në apel siç thekson se duhet të rinumërohen.

Në vendvotimin 0803C/01R pretendon se nga ky vendvotim në raportin e vëzhguesve në numrin e tij në listën e Subjektit Politik nr.7 i figurojnë 31 vota por në FRK ka vetëm 1 votë. Po ashtu në këtë vv pretendon se kopja e FRK-së e cila duhej të dorzohet te KKZ-ja në Klinë, është dorëzuar 3 ditë pas zgjedhjeve. Në vendvotimin 0807C/03R pretendon se në raportin e

vëzhguesve i figurojnë 5 vota, kurse në FRK 1 votë. Në vendvotimin 0810C/02D pretendon se ka marrë 14 vota kurse në FRK i figuron vetëm 1 votë.

Si provë ka bashkangjitur formularët për raportim nga vëzhguesit e subjektit të tij politik nga VV e cekura në apel.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 0803C/01R, 0807C/03R, 0810C/02D

Apeli është i bazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mungesë të votave të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Komunës së Klinës, Faton Berisha nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me nr. 7 në listën e subjektit LDK, siç rezultoi edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vetë pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për fletëvotimet për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Klinës, nga Subjekti Politik LDK dega në Klinë, në Vendvotimet: me nr. 0803C/01R, 0807C/03R, 0810C/02D , dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezultoi se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 914/2021 më datën 07.11.2021.

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.